



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1543 Prot.

Tiranë, më 15.12 2017

VENDIM Nr. 233, datë 13.12.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërbimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.13, datë 13.12.2017, pasi shqyrtoi *kërkesën nga FSHZH për ndryshim të vendimit Nr. 221 datë 31.10.2017*, të KKA për projektin "Rikonstruksioni i Shkallareve në Sarandë", të cilat pozicionohen në zonën arkeologjike "B" të qytetit të Sarandës. përkatësisht shfuqizimin e pikave 2, 3 dhe 4 të tij:

VENDOSI:

1. Të miratojë *kërkesën nga FSHZH për ndryshim të vendimit Nr. 221 datë 31.10.2017*, të KKA për projektin "Rikonstruksioni i Shkallareve në Sarandë", të cilat pozicionohen në zonën arkeologjike "B" të qytetit të Sarandës, përkatësisht shfuqizimin e pikave 2, 3 dhe 4 të tij.
2. Të kryhet nga DRKK Vlorë, Sektori Sarandë ndjekja periodike ditore e punimeve të gërmimit për projektin "Rikonstruksioni i Shkallareve në Sarandë", të cilat pozicionohen në zonën arkeologjike "B" të qytetit të Sarandës.
3. ASHA të verifikojë raportet e terrenit, të depozituar pranë saj nga DRKK Vlorë, Sektori Sarandë, e cila do të kryejë ndjekjen periodike ditore të punimeve të gërmimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.



SEKRETAR I KKA
RUBINA ZOTO